



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administratës Publike - Ministarstva Javne Uprave - Ministry of Public Administration

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Bruto prodhimi vendor në Kosovë për vitet 2004 - 2009



ENTI I STATISTIKËS SË KOSOVËS
ZAVOD ZA STATISTIKU KOSOVA
STATISTICAL OFFICE OF KOSOVA

BRUTO PRODHIMI VENDOR NË KOSOVË PËR VITET 2004 – 2009

Enti i Statistikës së Kosovës (ESK) publikon llogaritjet paraprake të Bruto Prodhimit Vendor (BPV) me çmime aktuale për vitet 2004 - 2009. Llogaritjet janë përpiluar nga Divizioni i Llogarive Kombëtare i ESK. Metodologjia për kalkulimin e BPV është sipas koncepteve dhe përkufizimeve të *Sistemit të Llogarive Kombëtare 1993 (SNA1993) dhe Sistemit Evropian të Llogarive 1995 (ESA95)*.

Ekzistojnë tri qasje për matjen e BPV: qasja e prodhimit, shpenzimeve dhe e të ardhurave.

BPV sipas qasjes së prodhimit, është shuma e bruto vlerës së shtuar e të gjitha njësive prodhuese rezidente, plus tatimet e zvogëluara për subvencionet në prodhim të cilat nuk janë të përfshira në vlerësimin e outputit.

BPV sipas qasjes së shpenzimeve është e barabartë me shumën e shpenzimeve të konsumit final (të ekonomive shtëpiake, qeverisë dhe institucioneve jo-profitabile të cilat iu shërbejnë ekonomive shtëpiake), formimin e bruto kapitalit (formimi i bruto kapitalit fiks dhe ndryshimet në inventar) dhe net eksportit të mallrave dhe shërbimeve (eksportet minus importet).

Pjesa më e madhe e shpenzimeve të konsumit final përbëhet nga shpenzimet për konsumin privat dhe burimet statistikore për vlerësimin e tyre janë kryesisht të dhënat nga Anketa e Buxhetit të Ekonomive Shtëpiake (ABESH). Për llogaritjen e konsumit final të ekonomive shtëpiake, të dhënat nga ABESH janë plotësuar me të dhëna shtese duke përdorur metodën e rrjedhës së mallit (të dhënat nga administrata tatimore, të dhënat e tregtisë së jashtme, të dhënat e tatimit në prone për llogaritjen e shpenzimeve të banimit si dhe të dhënat nga statistikat e bujqësisë).

Për llogaritjen e shpenzimeve të konsumit final të Qeverisë, burimi kryesor i të dhënave është Thesari, Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Në këtë kategori janë përfshirë: pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet dhe amortizimi i kapitalit fiks, të gjitha këto të zvogëluara për shitjet.

Për llogaritjen e shpenzimeve për konsum final të Institucioneve jo profitabile (jo fitimprurëse) që iu shërbejnë ekonomive familjare, burim i të dhënave janë pasqyrat financiare të Organizatave Joqeveritare (OJQ), nga Ministria e Administratës Publike dhe të dhënat nga Partitë Politike, nga OSBE (deri në vitin 2007).

Formimi Bruto i Kapitalit Fiks (FBKF) bazohet në të dhënat e importit dhe eksportit, të dhënat administrative dhe nga të dhënat e prodhimit vendor të materialit ndërtimor.

Ndryshimet në inventar janë llogaritur duke përdorur të dhënat nga anketa strukturore e ndërmarrjeve si ndryshim midis fundit dhe fillimit të vitit. Eksporti i mallrave dhe i shërbimeve përbëhet nga transaksionet në mallra dhe shërbime (shitjet, shkëmbimet, dhuratat ose grantet) nga rezidentët tek jo-rezidentët.

Importi i mallrave dhe shërbimeve përbëhet nga transaksionet në mallra dhe shërbime (blerjet, shkëmbimet, dhuratat dhe grantet) nga jo-rezidentët tek rezidentët.

Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave janë të dhënat e Doganës dhe të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), ndërsa për eksportin dhe importin e shërbimeve të dhënat janë ato nga Banka Qendrore e Kosovës të shprehura në Bilancin e Pagesave.

BPV-ja në Kosovë gjatë periudhës 2004-2009 është rritur nga 2,912.5 milion euro në 3,912.4 milion euro. BPV për kokë banori është rritur nga 1427 euro në 2004, në 1795 euro në vitin 2009.

Tabela 1 - BPV me çmime aktuale (Të dhënat provisionale)

	(në milion Euro)					
	2004	2005	2006	2007	2008	2009
BPV me çmime aktuale	2,912.5	3,002.9	3,120.4	3,393.7	3,851.4	3,912.4
Shpenzimet e konsumit final	3,212.7	3,367.6	3,466.2	3,810.6	4,344.6	4,279.9
Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake	2,487.6	2,638.4	2,770.8	3,145.9	3,646.7	3,584.3
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	701.5	705.5	670.6	641.6	674.4	670.5
Qeveria e Kosovës	355.5	329.2	340.8	327.3	372.6	409.7
Donatorët (pagat)*	346.0	376.3	329.8	314.3	301.8	260.8
Të punësuar të huaj	247.8	258.4	213.2	196.9	196.9	178.7
Të punësuar vendor	98.2	117.9	116.6	117.4	104.9	82.1
Shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH	23.5	23.7	24.8	23.1	23.6	25.0
Formimi i bruto kapitalit	701.2	722.2	798.3	892.5	1,093.9	1,166.5
Formimi i bruto kapitalit fiks	583.6	592.8	657.1	744.3	937.9	1,026.5
Ndryshimet në inventar	117.7	129.4	141.2	148.3	156.0	140.0
Eksperti neto	-1,001.4	-1,086.9	-1,144.1	-1,309.4	-1,587.1	-1,534.0
Eksperti i mallrave dhe shërbimeve	310.6	332.8	441.4	512.2	569.0	611.8
Eksperti i mallrave	63.8	67.8	122.5	177.2	217.5	177.2
Eksperti i shërbimeve	246.8	265.0	319.0	335.0	351.6	434.6
Importi i mallrave dhe shërbimeve	1,312.0	1,419.7	1,585.5	1,821.7	2,156.1	2,145.8
Importi i mallrave	1,046.9	1,146.3	1,295.6	1,545.2	1,885.7	1,850.6
Importi i shërbimeve	265.1	273.3	289.9	276.5	270.5	295.1
Popullsia (000)¹	2,041	2,070	2,100	2,130	2,153	2,180
BVP për kokë banori (Euro)	1,427	1,451	1,486	1,593	1,789	1,795

*Përfshinë pagat e të punësuarve rezident të UNMIK-ut, Eulex-it (personelit lokal dhe të huaj të cilët qëndrojnë më gjatë se një vit në Kosovë).

¹www.ks-gov.net/esk Statistikat e lindjeve në Kosovë 2009.

Komponenti kryesor i BPV është konsumi final i ekonomive shtëpiake, i cili është rritur nga 2,487.6 milion euro në 2004 në 3,584.3 milion euro në 2009.

Tabela 2: Struktura e BPV sipas shpenzimeve

	2004	2005	2006	2007	2008	2009
BPV me çmime aktuale	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
Shpenzimet e konsumit final	110.3	112.1	111.1	112.3	112.8	109.4
Shpenzimet e konsumit final te ekonomive shtëpiake	85.4	87.9	88.8	92.7	94.7	91.6
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	24.1	23.5	21.5	18.9	17.5	17.1
Qeveria e Kosovës	12.2	11.0	10.9	9.6	9.7	10.5
Donatorët (pagat)	11.9	12.5	10.6	9.3	7.8	6.7
Të punësuar te huaj	8.5	8.6	6.8	5.8	5.1	4.6
Të punësuar vendor	3.4	3.9	3.7	3.5	2.7	2.1
Shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH	0.8	0.8	0.8	0.7	0.6	0.6
Formimi i bruto kapitalit	24.1	24.1	25.6	26.3	28.4	29.8
Formimi i bruto kapitalit fiks	20.0	19.7	21.1	21.9	24.4	26.2
Ndryshimet në inventar	4.0	4.3	4.5	4.4	4.1	3.6
Eksporti neto	-34.4	-36.2	-36.7	-38.6	-41.2	-39.2
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	10.7	11.1	14.1	15.1	14.8	15.6
Eksporti i mallrave	2.2	2.3	3.9	5.2	5.6	4.5
Eksporti i shërbimeve	8.5	8.8	10.2	9.9	9.1	11.1
Importi i mallrave dhe shërbimeve	45.0	47.3	50.8	53.7	56.0	54.8
Importi i mallrave	35.9	38.2	41.5	45.5	49.0	47.3
Importi i shërbimeve	9.1	9.1	9.3	8.1	7.0	7.5

Formimi i bruto kapitalit ka kontribuar me 29.8 për qind në BPV në vitin 2009. Shpenzimet e qeverisë së përgjithshme në periudhën 2004–2009 kanë përfaqësuar 24.1-17.1 për qind të BPV-së në vitin 2009.

Tab 3 - BPV me çmime konstante (me çmimet e vitit paraprak)

	2006	2007	2008	2009
	3,105.7	3,315.8	3,628.1	3,962.7
Shpenzimet e konsumit final	3,429.8	3,719.1	4,087.6	4,359.0
Shpenzimet e konsumit final te ekonomive shtëpiake	2,746.5	3,048.1	3,416.7	3,700.2
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	658.6	648.0	647.3	635.2
Qeveria e Kosovës	333.6	338.3	350.0	378.2
Donatorët (pagat)	324.9	309.7	297.3	257.0
Të punësuar te huaj				
Të punësuar vendor				
Shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH	24.8	23.1	23.6	23.6
Formimi i bruto kapitalit	753.5	831.0	1,028.9	1,211.0
Formimi i bruto kapitalit fiks	621.1	692.8	885.1	1,065.7
Ndryshimet në inventar	132.1	137.9	143.8	142.9
Eksporti neto	-1,077.6	-1,234.3	-1,488.4	-1,607.4
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	420.7	476.1	511.4	636.2
Eksporti i mallrave	103.8	155.5	189.9	190.9
Eksporti i shërbimeve	317.0	320.6	321.5	445.3
Importi i mallrave dhe shërbimeve	1,498.4	1,710.4	1,999.8	2,243.5
Importi i mallrave	1,214.7	1,439.6	1,737.9	1,949.3
Importi i shërbimeve	283.7	270.8	261.8	294.3
BPV - Norma reale e rritjes	3.4	6.3	6.9	2.9

Bazuar në të dhënat paraprake te BPV, rritja reale për vitin 2009 ishte 2.9% (shkalla e deflacionit në vitin 2009 ishte -2.4%)

Enti i Statistikës së Kosovës

përshkrim i shkurtër

Enti i Statistikës së Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Enti ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Enti financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Enti i Statistikës së Kosovës vepron sipas Rregullores 2001/14 e cila ka hyrë në fuqi me 2 Korrik 2001. Ligji për statistikën zyrtare të Kosovës është në proces për miratim. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Enti i statistikës së Kosovës ka këtë strukturë organizative: Departamentet prodhuese; (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse;** (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti i administratës. **Në kuadër të Entit vepron edhe;** Zyra për regjistrimin e popullsisë ekonomike familjare dhe banesave si dhe **Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 134 punëtorë, prej tyre, 96 (71.6%) në seli të Entit, gjersa në Zyrat Rajonale, 38 (28.4%), Enti ka këtë strukturë kualifikuese, 65.4% me shkollim universitar ndaj 34.6% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikën e shteteve në rajon.

Enti i Statistikës së Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Jemi në vllugun e përgatitjeve përfundimtare për realizimin e Projektit madhor për shtetin e Kosovës; *Regjistrimi i popullsisë ekonomike familjare dhe banesave* i cili më në fund do të realizohet prej 1-15 prill 2011 (i fundit është bërë në vitin 1981). Në këtë projekt madhor janë angazhuar akademik, shkencëtarë si dhe ekspertë vendorë dhe ndërkombëtar në të gjitha grupet punuese.

Misioni i Entit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë , bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informatat të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- o **Adresa:** **ENTI I STATISTIKES SE KOSOVES,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- o **Telefoni:** +381 (0) 38 235 111,
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 235 111 102
- o **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- o **E-mail:** economic@ks-gov.net
- o **Ueb-faqe:** www.ks-gov.net/esk